



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 711/7 prot.

Datë 28.04.2022

V E N D I M

Nr. 384/ 2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28 . 04.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-18454-02-02-2022, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK .
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.02.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-18454-02-02-2022, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666. lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2 Në datën 16.03.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku rezultojnë si vijon:

1. “InfoSoft Office” SHPK	4.581.711 lekë, skualifikuar
2. “Interlogistic” SHPK	4.611.250 lekë, skualifikuar
3. “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK	5.234.220 lekë, kualifikuar
4. “Library Dyrrahu” SHPK	5.555.555 lekë, skualifikuar
5. “Adenis Kastrati” P.F	5.744.890 lekë, skualifikuar
6. “EUROPRINTY GROUP” SHPK	5.953.000 lekë, kualifikuar

II.3 Operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: “- Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstatoi se dokumenti i vetedeklarimit është paraqitur jo sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi mungon një prej elementëve formal më të rëndësishëm të saj. Operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8 ka nënshkruar vetëm në faqen e fundit të shtojcës që i përket Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B:

DEKLARATËS Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ndërsa në deklaratat e tjera të ngarkuara nga Operatori Ekonomik mungon nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.

-VENDIM K.P.P. 254/2019 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve teknike të kerkuara konkretisht: Artikulli nr.4 Leter A3 e Trashes 270 gr nuk ka specifikimet e kerkuara ne ambalazhin e paraqitur as nje reference prodhimi ose marke ne te cilen Autoriteti Kontraktor mund ta kontrrolloje.

Artikulli 68 Kuti archive mungon kartoni i dyfishte ne pjesën e poshtme.”

II.4. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se më datë 30.03.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Në datë 04.04.2022 në buletin nr.43 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK.

II.5 Në datën 06.04.2022 pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 711 prot., e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit, duke kërkuar kundërshtim të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të tij.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ka publikuar formularin e publikimit nr. 711/2 prot., datë 06.04.2022 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin nr. 2889/2 prot., e datës 08.04.2022 ka vendosur mospranim të ankesës.

II.8. Më datë 12.04.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa “Argumente shtesë” protokolluar me tonën me nr. 711/4, datë 13.04.2022, e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK , në lidhje me vendimin e KSHA-së.

II.9. Referuar arsyeve të skualifikimit, në datën 13.04.2022, me shkresën nr. 711/5 prot., “Kërkesë për dorëzimin e mostrave”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

II.10. Me shkresën nr.3341prot., datë 20.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 711/6, datë 20.04.2022 “Kthim përgjigje dhe mostra”, autoriteti kontraktor “Bashkia Kamëz” ka përcjellë mostrat, procesverbalin e vlerësimit të tyre si dhe dokumentacion shoqërues dorëzuar nga “InfoSoft Office” SHPK .

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se:

“- Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstatoi se dokumenti i vetedeklarimit është paraqitur jo sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi mungon një prej elementëve formal më të rëndësishëm të saj. Operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8 ka nënshkruar vetëm në faqen e fundit të shtojcës që i përket Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: DEKLARATËS Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ndërsa në deklaratat e tjera të ngarkuara nga Operatori Ekonomik mungon nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.

-VENDIM K.P.P. 254/2019 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve teknike të kerkuara konkretisht: Artikulli nr.4 Leter A3 e Trashe 270 gr nuk ka specifikimet e kerkuara ne ambalazhin e paraqitur as nje reference prodhimi ose marke ne te cilen Autoriteti Kontraktor mund ta kontrrolloje.

Artikulli 68 Kuti archive mungon kartoni i dyfishte ne pjesen e poshtme.”

III.1.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 8 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ---
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- --
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

<i>gjkata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.</i>	
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP së</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</i>	<hr/>

<i>Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</i>	<i>Po []</i>
<i>Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</i>	<i>Po []</i>
<i>Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</i>	<i>Po []</i>
<i>Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</i>	<i>Po []</i>
<i>Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</i>	<i>Po []</i>
<i>Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</i>	<i>Po [] Jo []</i>
<i>Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</i>	<i>Po [] Jo []</i>
<i>Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</i>	<i>Po [] Jo []</i>
<i>Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</i>	<i>Po [] Jo []</i>
<i>Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

C: DEKLARATA**Mbi Konfliktin e Interesit**

Deklarata	
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</p> <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.</p> <p>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.</p> <p>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".</p> <p>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.</p>	

D: DEKLARATA**Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të	Po [] Jo []

<i>punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</i>	
<i>Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimittë përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i>	<i>Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Profili i punonjësve Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete:</i>
<i>Data e dorëzimit të deklaratës _____</i>	<i>Vula _____</i>
<i>Emri, Mbiemri, Firma _____</i>	

Ju lutemi sigurohuni që:

-Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit (shtojca 8) dorëzuar në SPE.

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

III.1.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.6. Vendosija e kriterëve të kualifikimit, ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat

që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteret e përgjithshme të kualifikimit duhet të përmbushen, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin: *“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se dokumenti i vetëdeklarimit është paraqitur jo sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi mungon një prej elementëve formal më të rëndësishëm të saj. Operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8 ka nënshkruar vetëm në faqen e fundit të shtojcës që i përket Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: DEKLARATËS Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ndërsa në deklaratat e tjera të ngarkuara nga Operatori Ekonomik mungon nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, siç parashikohet në dispozitat e sipërcituara në fushën e prokurimit publik. Në çdo rast AK mund ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik për paqartësi apo verifikime mbi dokumentin në përputhje me neni 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”:*

“Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

Referuar Formularit të Vetëdeklarimit të plotësuar nga OE dorëzuar SPE nga subjekti “InfoSoft Office” SHPK, vërehet se janë plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në formular, si edhe është plotësuar pjesa e fundit e formularit ku kërkohet data e dorëzimit, emri, mbiemri, firma si edhe vula e shoqërisë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit “Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve teknike të kërkuara konkretisht:

Artikulli nr.4 Letër A3 e Trashes 270 gr nuk ka specifikimet e kërkuara në ambalazhin e paraqitur as një reference prodhimi ose markë në të cilën Autoriteti Kontraktor mund ta kontrollojë.

Artikulli 68 Kuti archive mungon kartoni i dyfishte ne pjesën e poshtme.”

III.2.1 Referuar Nenit 36, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato

ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specififikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.2 Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.3 Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit

III.2.4. Nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndyshuar, kërkohet shprehimisht:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i*

kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.2.5 Referuar dokumenteve të tenderit, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, Kapaciteti teknik: Pika 2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK-së në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër fizike për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 35, 36, 37,51,52,53,54,55,56,57,58,59,63,64,68, 69,70,71,72. Këto kampione do të verifikohen nga enti prokurues dhe do të mbahet një procesverbal për përmbushjen ose jo të specifikimeve teknike.*

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht skualifikimi.

Referuar dokumenteve të tenderit e konkretisht specifikimeve teknike të artikujve nr. 4 dhe nr 68 janë si vijon:

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
4	Leter A3 e Trashe	Formati A3, 270g/m ² , Ngjyra Avorio, 100 x A3, 297 x 420 <i>Ekivalent me Letren Claire Fontaine</i>
68	Kuti arshive	ndërtuar nga karton i fortë, ku faqet anësore te kene fortesi te dyfishte, pjesa fundore me trashesi te dyfishte. Te jete e bere me fibra celuloze dhe nuk duhet te kete shtresa te ngjitura ose te kapura.

III.2.6. Me shkresën nr.3341prot., datë 20.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 711/6, datë 20.04.2022 “Kthim përgjigje dhe mostra”, autoriteti kontraktor “Bashkia Kamëz” ka përcjellë mostrat, procesverbalin e vlerësimit të tyre, si dhe dokumentacion shoqërues dorëzuar nga “InfoSoft Office” SHPK .

III.2.7 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se

operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

III.2.8. Referuar arsyeve të skualifikimit, në datën 13.04.2022, me shkresën nr. 711/5 prot., “Kërkesë për dorëzimin e mostrave” Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre në këtë procedurë prokurimi objekt-ankimi.

III.2.8.1 Me shkresën nr.3341prot., datë 20.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 711/6, datë 20.04.2022 “Kthim përgjigje dhe mostra”, autoriteti kontraktor “Bashkia Kamëz” ka përcjellë mostrat dorëzuar nga operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK., procesverbalin e vlerësimit të tyre si dhe dokumentacion shoqërues.

III.2.8.2. Referuar kriterit të veçantë të kapaciteteve teknike, të modifikuar, rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesin pranë AK mostra për disa nga artikujt e renditur në shtojcën 6 e ndër to edhe për artikujt nr. 4 dhe nr. 68. Gjithashtu, në shtojcën e publikuar për modifikimin e specifikimeve teknike janë parashikuar specifikimet teknike për art. nr.4: “*Formati A3, 270g/m², Ngjyra Avorio, 100 x A3, 297 x 420 Ekuivalent me Letren Claire Fontaine*”.

III.2.9 Nisur nga arsyeja e skualifikimit, pretendimeve të ankimuesit, si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ky i fundit për artikullin “nr. 4 Letër A3 e Trashë” e cila është e paketuar dhe ka etiketën me të dhënat e letrës (formati A3, pesha 270 g/m² ngjyra Avorio), të dhëna të cilat përkojnë me specifikimet teknike kërkuar në DST. Gjatë vlerësimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, Autoriteti Kontraktor nëse e gjykon të arsyeshme kërkon sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues për paqartësi në lidhje me mostrat e dorëzuara të artikujve, në përputhje me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”

“Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

Gjithashtu referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në shtojcën 6, për artikullin “*nr. 4 Letër A3 e Trashë Formatit A3, 270g/m², Ngjyra Avorio, 100 x A3, 297 x 420 Ekuivalent me Letren Claire Fontaine*” si edhe kërkesës mbi dorëzimin e mallrave ku shprehimisht kërkohet :

“Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazhuara si më poshtë:

- *Ambalazhimi të jetë në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.*
- *Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit.*
- *Ambalazhet duhet të kenë elementet e sigurisë të pademtuara,*

- *Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.*

Komisioni vëren, se AK nuk ka parashikuar, që në ambalazh duhet të jenë parametra apo dhe të dhënat e skedës teknike apo specifikime teknike të artikujve, e cila të përbëjë shkallë kualifikimi siç ka argumentuar AK në arsyet e skualifikimit të ankimuesit ku shprehet se: *“Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve teknike të kërkuara konkretisht:*

Artikulli nr.4 Letër A3 e Trashes 270 gr nuk ka specifikimet e kërkuara në ambalazhin e paraqitur as një reference prodhimi ose markë në të cilën Autoriteti Kontraktor mund ta kontrollojë.

Komisioni gjykon, se Autoriteti Kontraktor nuk mund të skualifikojë për një kriter të pakërkuar në dokumentet e tenderit siç ka vepruar në rastin konkret.

Sa më sipër, referuar specifikimeve teknike, kritereve të veçanta të kualifikimit, si dhe nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , konstatohet, se mostra përmban të gjitha elementet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, të cilat vërtetojnë origjinalitetin dhe përmbushjen e specifikimeve teknike të art. *“nr. 4 Letër A3 e Trashë”*.

III.2.10 Për sa i përket arsyes tjetër të skualifikimit në lidhje me *“art. 68 kuti arkive”*, si edhe pretendimeve të ankimuesit, nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, KPP konstatoi, se ky i fundit për artikullin *“nr. 68. Kutia arkive”*, ka paraqitur mostër kuti arkivi prej kartoni të trashë dhe shtresa fundore karton i përbërë nga dy shtresa, si dhe një shtresë e tretë në mes e valëzuar, ndërsa faqet anësore me dopio karton. Kutia nuk ka shtresa të ngjitura apo të kapura.

Referuar specifikimeve teknike AK ka përcaktuar *“kutia arkivi ndertuar nga karton i forte, ku faqet anësore të kene fortesi të dyfishte, pjesa fundore me trashësi të dyfishte. Të jete e bere me fibra celuloze dhe nuk duhet te kete shtresa te ngjitura ose te kapura”*.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se në specifikimet teknike nuk janë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë të hollësishme të dhëna për kuti arkivi, si (përmasa, peshë specifike e kutisë, trashësia e kartonit), mbi të cilat të kryhet verifikimi me saktësi. AK ka bërë vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë në mënyrë apriori pa argumentuar me saktësi arsyen e skualifikimit.

Nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mostra e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , për artikullin *“nr. 68 Kutia arkive”* përmbush kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara në DST.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-18454-02-02-2022, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 6,066,666.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK .
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri